



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 661 Prot.

Tiranë, më 29.04.2024

V E N D I M

Nr. 120, Datë 29.04.2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën nr. 182, datë 25.09.2023, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”³, përfaqësuar nga znj. S. L, Drejtore Ekzekutive, kundër Tirana Parking, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuar, lidhur me garantimin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se, në Sheshin “Skënderbej” dhe Sheshin “Italia”, ashenësorët nuk punojnë duke bërë të pamundur përdorimin e vendeve të rezervuara pa pagesë për personat me aftësi të kufizuar dhe nuk ka numrin e duhur të vendeve të parkimit për kapacitetin që ka dhe janë gjithmonë të zëna nga mjetet e tjera.

Në parkimet e tjera në sipërfaqe, nuk ka fare vende të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar, si, parkimi tek “Zogu i Zi” dhe Stadiumi “Selman Stërmasi”.

Nëpër rrugë numri i vendeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar është zero ose i pakët dhe jo në përputhje me rregulloren, ose janë të zëna nga mjete të tjera.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri rregullimin e situatës dhe plotësimin e të gjitha standarteve dhe nevojave për personat me aftësi të kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim do t'i referohemi me “Pala ankuese”

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’ a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*.

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon diskriminim e personave me aftësi të kufizuara. Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’ju përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1034/1 prot., datë 11.10.2023, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën.

2. Me shkresën nr.1770/1 prot datë 27.10.2023, Tirana Parking, ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën duke parashtruar ndër të tjera:

Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkik Tiranë Nr.48, datë 11.11.2015 *“Për Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë”* dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr.49, datë 11.11.2015 *“Për Miratimin e Kritereve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe nënzonave të destinuara për Parkim”*, i ndryshuar, Tirana Parking, është institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, i cili administron shërbimin e Parkimit Publik me Pagesë mbi dhe nën tokë.

Në lidhje me vendparkimet e rezervuara për invalidë, Tirana Parking bën me dije se, sheshparkimet mbi dhe nëntokë, të cilat administrohen nga Tirana Parking, ofrojnë hapësira parkimi për personat me aftësi të kufizuara. Sheshi “Italia”, Shehi “Skënderbej”, Sheshparkimi “Asllan Rusi” dhe “Selman Stërmasi”.

Tirana Parking informon se:

- Numri total i vendeve në sheshparkimin nëntokësor Sheshi “Skënderbej” është 303 vende dhe 6 prej tyre janë vendparkime për personat me aftësi të kufizuara.
- Numri total i vendeve nëntokësor Sheshi “Italia” është 198 dhe 2 prej tyre janë vendparkime për personat me aftësi të kufizuara.
- Numri total i vendeve në sheshparkimin “Asllan Rusi” është 76, ku 2 prej tyre janë vendparkime për personat me aftësi të kufizuara.
- Numri total i vendeve në sheshparkimin “Selman Stërmasi” është 84, ku 1 prej tyre është për personat me aftësi të kufizuara.

Monitorimi i hapësirave për vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara realizohet nga inspektorët të cilët ofrojnë shërbim në këto sheshparkime, gjithashtu nga përditshmëria nuk janë hasur problematika në lidhje me zënien e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me informacionin për parkimet të cilat janë në administrim të Tirana Parking (numri i tyre dhe vendodhjen) në territorin e Bashkisë Tiranë dhe vendparkimet për personat me aftësi të kufizuara (numrin dhe vendndodhjen), Tirana Parking informon se:

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1503 datë 19.11.2018 *“Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*, konkretisht neni 8, pika 3.3. i rregullave teknike dhe standardeve për garantimin e mundësisë së hyrjes përshtatshmerisë dhe fushëpamjes në ndërtesa”, parashikohet se:

“Parkimet duhet të vendosen në masën minimale 1 në çdo 50 vende makinash, me gjerësi jo më të vogël se 320 m dhe e rezervuar falas për makinat e personave me aftësi të kufizuar”.

Për sa më sipër, vendet e parkimit janë të përcaktuara bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak, Tiranë Nr.49, datë 11.11.2015 *“Për miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të*

administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim”, i ndryshuar, Urdhëresat e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, konkretisht:

- Urdhëresë nr. 14228, datë 11.5.2016 mbi “Detajimin në vende parkimi i nënzoneve të destinuara për parkim “NDP të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.49 të datës 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës”
- Urdhëresë nr.20887, datë 06.07.2016 mbi “Detajimin në vende parkimi i nënzoneve të destinuara për parkim “DNP” të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.49, të datës 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”.
- Urdhëresë nr.17118, datë 09.05.2017 mbi “Detajimin në vende parkimi i nënzoneve të destinuara për parkim “NDP” të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.49 të datës 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës”.
- Urdhëresë nr.12575, datë 19.03.2019 mbi “Detajimin në vende parkimi i nënzoneve të destinuara për parkim “NDP” të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.49 të datës 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës” dhe Vendimin nr.48, datë 11.11.2015 të Këshillit Bashkiak “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”.
- Urdhëresë nr.45766, datë 17.11.2021 mbi “Detajimin e nënzoneve të destinuara për parkim në rrugë dhe/ose jashtë rruge me ose pa pagesë, brenda zonave të administrimit të parkimit “ZAP”, të miratuara me vendim nr.132, datë 19.10.2021 të Këshillit Bashkiak.

Vendet e parkimit sipas Zonave A, B, C:

Në zonën A të administrimit janë të përfshira 38 rrugë në të cilat përfshihen 1041 vende me pagesë, 582 vende pa pagesë dhe 48 vende invalidi⁴.

Në zonën B të administrimit janë të përfshira 25 rrugë në të cilat përfshihen 817 vende me pagesë 566 vende pa pagesë dhe 25 vende invalidi.

Në zonën B të administrimit janë të përfshira 8 rrugë në të cilat përfshihen 342 vende me pagesë 315 vende pa pagesë dhe 13 vende invalidi.

⁴ Termi “invalid” është terminologji e papërshtatshme për t’u përdorur. Terminologjia që duhet përdorur gjithmonë është termi persona me aftësi të kufizuara.

3. Me e-mailin e datës 3.11.2023, pala ankuese ka depozituar kundërshtimet e saj, pasi u njoh me shkresën e mësipërme të Tirana Parking. Ndër të tjera, pala ankuese parashtron:

Nuk jemi në gjendje të konfirmojmë nëse numrat e dhënë nga Tirana Parking janë të sakta, por mund të parashtrijmë sa vijon:

- Tek Selman Stermasi, i vetmi vend parkimi për persona me aftësi të kufizuara nuk mund të shfrytëzohet sepse është i mbyllur me çelësa.
- Tek Asllan Rusi ka vetëm një vend parkimi për personat me aftësi të kufizuara.
- Numrat ekzistues të parkingjeve për personat me aftësi të kufizuara janë gjithmonë të zëna nga qytetarët e tjerë dhe askush nuk po merr masa për t'i mbajtur ato të lira për ata që kanë nevojë, qoftë edhe në parkingjet e mbyllura, aq më pak në rrugë.
- Numri që jepet nga kompania është drastikisht nën kërkesën 5%.
- Projektimi ekzistues i hapësirave të parkimit, nuk është në përputhje me standardet teknike të parashikuara në rregullore.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 1034/2 prot., datë 11.12.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 21.12.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua datën 21.12.2023, me pjesëmarrjen e palës ankuese, Fondacionit “Së Bashku, përfaqësuar nga znj.S. L, Drejtore Ekzekutive, Tirana Parking, përfaqësuar nga z. J. T dhe z. D. Gj dhe Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga znj.M. L.

Gjatë seancës dëgjimore pala ankuese konfirmoi se tek Asllan Rusi janë dy vende parkimi për personat me aftësi të kufizuara, ndryshe nga sa është pretenduar në ankesë. Ajo deklaroi se numri i vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara është i ulët dhe jo sipas përcaktimeve ligjore, vijëzimi i vendparkimeve nuk është sipas standardeve, tek Selman Stermasi vendi i parkimit për personat me aftësi të kufizuara është gjithmonë i zënë. Ka vështirësi me ashensorët dhe vendet e parkimit janë gjithmonë të zëna nga mjete të tjera.

Përfaqësuesit e Tirana Parking, deklaruan se i qëndrojnë përgjigjes me shkrim që kanë depozituar pranë Komisionerit në lidhje me ankesën. Ata deklaruan se, Tirana Parking është një institucion varësie i Bashkisë Tiranë dhe janë zbatues të politikave të saj si institucion epror. Tirana Parking ka të drejtën që të shtojë numrin e vendeve në rrugë. Në lidhje me vendparkimin tek Stadiumi Dinamo, u deklarua se ai qëndron i mbyllur me çelës për të mos u zënë nga mjete të tjera pasi ruhet për një person me aftësi të kufizuara, i cili punon gjithmonë aty. Pra, ai vend është i disponueshëm gjithmonë për personat me aftësi të kufizuara. Për sa i përket problematikës së ashensorëve, përfaqësuesit e Tirana Parking u shprehën se, e kanë identifikuar si problematikë dhe do marrin masa për këtë aspekt teknik. Ashensorët janë jashtë funksionit dhe janë çaktivizuar nga ana e tyre për arsye sigurie. Është planifikuar një fond për vitin në vijim për të kontraktuar një subjekt i cili do të kryejë verifikimet përkatëse në lidhje me gjendjen teknike

të ashensorëve. Përfaqësuesit e Tirana Parking theksuan se, sa i takon numrit të vendeve të parkimit, sigurisht që do të shtohen dhe gjithashtu sinjalistika mund të realizohet.

Gjatë seancës dëgjimore, pala ankuese deklaroi se meqënëse kemi të bëjmë me një institucion publik, pjesë e Bashkisë Tiranë është mundësia që të zgjidhet me bashkëpunim.

Bazuar në nenin 33, pika 9, të LMD, ku përcaktohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*, Komisioneri iu komunikoi palëve mundësinë e parashikuar nga LMD për të arritur një marrëveshje pajtimi midis tyre në lidhje me çështjet e parashtruara në ankesë dhe qëndrimet e tyre në rast të arritjes së një marrëveshje t’ia komunikonin Komisionerit.

Nëpërmjet *e-mailit* të datës 14.2.2024, pala ankuese informoi Komisionerin se, në vijim të seancës dëgjimore, nuk ka patur asnjë marrëveshje midis palëve.

5. Në kushtet kur midis palëve nuk u bë e mundur arritja e një marrëveshje, Komisioneri me shkresën nr.324 prot., datë 20.2.2024, iu drejtua Tirana Parking me një kërkesë për informacion. Nëpërmjet shkresës nr.599/1 prot datë 8.3.2024, Tirana Parking ktheu përgjigje, duke parashtruar si vijon:

Lidhur me kërkesën e plotësimit në masën 5% të vendeve të parkimit të dedikuara për kategorinë PAK, sqarojmë se, Tirana Parking, në cilësinë e strukturës që administron parkimin publik me pagesë në rrugë dhe sheshet e parkimit nëntokësore dhe mbitokësore me pagesë, ka nisur procesin e shtimit të vendparkimeve të dedikuara për kategorinë PAK.

Konkretisht, në muajin dhjetor 2023 janë kryer vijëzime tërësore në sheshin e parkimit nëntokësor “Skënderbej” ku numri total i vendeve të dedikuara është rritur nga 6 vende që ka qenë në 15 vende (303 vende parkimi në total). Gjithashtu në sheshin e parkimit mbitokësor që ndodhet në sheshin “Fryderyk Franciszek Chopin” vendet e dedikuara për kategorinë PAK janë rritur nga 1 vend që ka qenë në 4 vende (80 vende parkimi në total).

Plotësimi në masën 5% të vendeve të dedikuara në sheshet e tjera të parkimeve, respektivisht, sheshi i parkimit “Selman Stërmasi”, sheshi i parkimit “Asllan Rusi”, sheshi i parkimit “Italia”, sheshi i parkimit “Bulevardi i ri”, sheshi i parkimit “Rruga e Elbasanit”, sheshi i parkimit “Zoo Park” dhe sheshi i Parkimit “Diga” do të vijojnë gjatë vitit 2024 me hyrjen në fuqi të kontartës së re të shërbimit të vijëzimit, në përputhje me grafikun e parashikuar për vijëzimin e shesheve të parkimit.

Sa i takon mbajtjes së lirë të vendeve të parkimit të dedikuara për PAK, Tirana Parking në vijimësi ka kërkuar dhe vijon të kërkojë ndihmën e Policisë Bashkiake për marrjen e masave administrative për drejtuesit e mjeteve që parkojnë mjetet në vendet e dedikuara për PAK. Tirana Parking, nuk ka kompetencë për marrjen e masave administrative ndaj drejtuesve që kryejnë kundravajtje rrugore, ku përfshihen edhe parkimet në kundërshtim me sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Referuar pikës 1, të nenit 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 *“Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar masat administrative kryesore “gjobë” dhe masat

plotësuese “heqja e mjeteve”, të parashikuara në nenet 156, 157 të Kodit Rrugor, vendosen vetëm nga shërbimet e policisë rrugore, respektivisht nga Policia Rrugore pjesë e Ministrisë së Brendshme dhe Policia Bashkiake.

Në lidhje me vijëzimin sipas standardeve, sqarojmë se vijëzimi i vendeve të dedikuara për PAK kryhet në përputhje me parashikimet e nenit 147 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “*Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar. Koncretisht vendet e dedikuara janë të pajisura me sinjalistikën horizontale përkatësisht me shirita të verdhë (kufizimet) dhe kundërshënuara me simbolin përkatës. Gjithashtu, vendet e dedikuara në sheshparkimet nëntokësore e mbitokësore përveç sinjalistikës horizontale janë të pajisura edhe me sinjalistikën vertikale përkatëse.

Në lidhje me procesin e mirëmbajtjes dhe certifikimit të ashensorëve, Tirana Parking, bën me dije se, në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.125, datë 22.12.2023 “*Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2024*” Tirana Parking ka hartuar dhe miratuar rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2024, ku është përcaktuar marrja e shërbimit të ekspertizës për ashensorët. Aktualisht ekspertët e licensuar janë duke punuar për qartësimin e gjendjes teknike të ashensorëve dhe hartimin e preventivave të shërbimeve që do të kryhen për marrjen e certifikimeve të sigurisë për të gjithë ashensorët.

6. Nëpërmjet e-mailit të datës 12.03.2024, pala ankuese pasi u njoh me përgjigjen e mësipërme, parashtroi si vijon:

Kur bëhet fjalë për parkimin e rezervuar për personat me aftësi të kufizuara, duhen zbatuar standartet teknike të bazuara në VKM nr.1503, datë 19.11.2008, e cila njihet si rregullore teknike edhe nga ligji nr.107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”. Dizajni i hapësirave të parkimit që tregohet në fotot e depozituara nga Tirana Parking, nuk përputhet me standardet teknike dhe nuk i lejon personat me aftësi të kufizuara të parkojnë makinat e tyre në mënyrë të pavarur. Vetëm shtimi i disa hapësirave të rezervuara të parkimit në vetëm 2 parkime në të gjithë Tiranën dhe pa respektuar standartet teknike, është larg garantimit të barazisë dhe dinjitetit për personat me aftësi të kufizuara.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Pretendimet e palët ankuese konsistojnë në tre momente:

- numri i vendeve të parkimit të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara në Tiranë është nën nivelin 5% të përcaktuar nga kuadri ligjor në fuqi;
- vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi;
- mosfunksionimi i ashensorëve në Sheshin “Skënderbej” dhe Sheshin “Italia”;
- mbjatatja e vendeve të parkimit të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që të mos zihen nga mjete të tjera.

Sipas palës ankuese, një situatë e tillë diskriminon personat me aftësi të kufizuara të cilët për shkak të numrit të vogël të vendeve të parkimit të rezervuara për ta, mungesës së standardeve të vendeve të parkimit dhe fakti që vendet e parkimit të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara nuk janë të lira, pasi zihen nga mjete të tjera, nuk mund të lëvizin lirisht dhe në baza të parabarta me të tjerët në territorin e administruar nga Tirana Parking.

Neni 23, i Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, parashikon funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Në këtë nen parashikohet se:

“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

1. *Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.*
2. *Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.*
3. *Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.*
4. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.*
5. *Ndriçimin e mjediseve publike;*
6. *Transportin publik vendor.*
7. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.*
8. *Shërbimin e dekorit publik.*
9. *Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.*
10. *Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.*
11. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.*
12. *Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.*
13. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*
14. *Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”*

Neni 29, pika 4 e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, parashikon funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike. Në këtë nen parashikohet se: “*Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve: 4. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore*”.

Në Ligjin nr. 8378/1998 “Kodi Rrugor i republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“*Neni 7; Rregullimi i qarkullimit në qendrat e banuara, pika 1: Në qendrat e banuara, bashkitë, me urdhëresë të kryetarit të pushtetit lokal, duhet:..... d) të rezervojë hapësira të caktuara për qëndrimin e mjeteve të organeve të policisë rrugore sipas nenit 12, të zjarrfikëseve, të shërbimit të ndihmës së shpejtë dhe të atyre në shërbim të personave me aftësi të kufizuara lëvizëse, të pajisura me shenja speciale, ose për mjetet e shërbimit në linjë për qëndrimin e tyre në stacionet fundore të linjave;*”;

Neni 12; Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore dhe e kontrolleve të tjera në rrugë, pika 1: Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore të përcaktuara nga ky Kod i takon: c) policisë së bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të bashkisë, të parashikuara në nenin 7, me përjashtim të pikës 12 të tij, nenin 11 pika 1 shkronjat “a” dhe “e”, nenin 85, 86, 87, 89, 155 pika 6, 156 pika 1 shkronjat “g” dhe “h”, pika 2 shkronjat “d”, “e”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k” dhe “l”;

Neni 186; Qarkullimi dhe pushimi i mjeteve në shërbim të invalidëve, pika 1: Për qarkullimin dhe pushimin e mjeteve në shërbim të invalidëve, entet pronare të rrugës janë të detyruara të ndërtojnë dhe mirëmbajnë strukturat përkatëse, si dhe sinjalizimin e nevojshëm për të lejuar e lehtësuar lëvizjen e tyre, siç është përcaktuar në aktet në zbatim”.

Bazuar në vendimin Nr.48, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak Tiranë (VKB) “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”, është krijuar Tirana Parking, si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë. Bazuar në pikën 1, të VKB-së së sipërcituar detyrat kryesore institucionale e funksionale të Tirana Parking janë:

- a. të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë të Bashkisë së Tiranës, mbi tokë dhe nëntokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim;
- b. të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës;
- c. të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;
- ç. të instalojë dhe mirëmbajë sinjalistikën rrugore të parkimit;
- d. të konstatojë dhe të vendosë gjopa për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimin përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit;
- e. të arkëtojë gjobat e vëna në kuadër të konstatimit të një kundërvajtje administrative për shkelje që kanë të bëjnë me parkimin;

- f. të kryejë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk bie në kundërshtime e që lidhet direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale, si dhe të kryejë detyrat që i ngarkohen njësisë së qeverisjes vendore në kuadër të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë;
- g. t'i propozojë Bashkisë së Tiranës përmirësimin e politikave të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë.

Nëpërmjet VKB nr.25, datë 17.03.2023, shkronja “d” e pikës 1, të VKB nr.48, datë 11.11.2015 është shfuqizuar.

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Tiranë është autoriteti përgjegjës në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në territorin e juridiksionit të saj. Përgjegjësitë e saj lidhen me sigurimin e parkimeve për personat me aftësi të kufizuar, sigurimin e sinjalistikës rrugore për këto parkime dhe sigurimin e moszënies së këtyre parkimeve nga përdorues të tjerë. Nëpërmjet VKB-së nr.48, datë 11.11.2015, të ndryshuar, Bashkia Tiranë ka krijuar Tirana Parking, si institucion varësie, si institucion përgjegjës për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë mbi dhe nën tokë, në territorin e Bashkisë Tiranë.

Bazuar në VKB nr.49, datë 11.11.2015 “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe të tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”, në gjermën “a”, pika 3, e Aneksit 1, përcaktohet:

“3. Kriteret për përcaktimin e NDP⁵ pa pagesë në rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nën tokë) brenda ZAP-ve janë:

- a. *rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e personave me aftësi të kufizuar (PAK) dhe parkimit të lirë pa roja ose pa sisteme (PL) në një masë jo më të vogël se 5 % e NDP.”*

Me ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁶, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁷. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni1).

⁵ Nënzona të Destinuara për Parkim.

⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambjentit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gjermanisht “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë pa aftësia/pa aftësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambjentet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga KDPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: “2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun;....”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim ligji nr. 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët”.

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore,

veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika”.

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 4/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën komunitare dhe qytetare (neni 5/1⁸).

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1074/2015). Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohej pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat dhe përfshin të gjitha ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008). Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

“PJESA I

Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Kreu I

Të përgjithshme

⁸ “Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare”.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Neni 1

Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.
2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.
3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:
 - të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;
 - ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;
 - ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.

Neni 2

Përshtatja e objekteve ekzistuese

1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe të llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.
2. Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.
3. Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.
4. Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.
8. Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.
9. Elementet e eliminimit të barrierave - janë pjesë të objekteve ndërtimor ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira dhe pajisje ËC, banja , kuzhine, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet

elektrike, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi.

Në nenet 12 dhe 13, të pjesës së parë të rregullores, për parkimet parashikohet se:

“Neni 12, Parkimet;

1. Për parkimet vlejné rregullat e dhëna në pikën 2.3 të nenit 4 dhe standardet e dhëna në pikën 3.3 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.
2. Për vendet e rezervuara të vendosura paralelisht me drejtimin e lëvizjes, gjerësia duhet të jetë e tillë që të lejoj kalimin e një personi në karrige me rrota në mes të dy makinave. Kjo kërkesë është e plotësuar nëse gjatësia e vendit të makinës nuk është më e vogël se 6 m. Në një rast të tillë, gjerësia e një vendi të rezervuar për makinë nuk tejkalon gjatësinë e një vendi të zakonshëm për makinë (250 cm).
3. Vendet e rezervuara mund të kufizohen me vendosjen e mjeteve bllokuese të posaçme.

Neni 13, Qarkullimi dhe qëndrimi i mjeteve në shërbim të personave me aftësi të kufizuar

1. Personat mbajtës të shenjave dalluese, të klasifikuar sipas nenit 14 të pjesës së parë të kësaj rregulloreje, u lejohet nga autoritetet kompetente, qarkullimi dhe qëndrimi i mjetit në shërbim të tyre:
 - në vendet që nuk përbëjnë pengesë për trafikun;
 - në raste të ndërprerjes ose kufizimit të qarkullimit për motive të sigurisë publike;
 - në raste të ndërprerjes ose kufizimit të qarkullimit për interesa publike ose për nevoja me karakter ushtarak;
 - kur janë vendosur kushte ose ndalime të karakterit të përhershëm ose të përkohshëm;
 - kur ndalohet dhe kufizohet qëndrimi.
5. Në vendet e parkimeve ose vendet e qëndrimit, të pajisur me mekanizma të kontrollit të kohëzgjatjes së qëndrimit për ruajtjen e makinave, të paktën 1 në çdo 50 vende ose në fraksion të 50 vendeve të disponueshme duhet të jenë të rezervuara falas për personat mbajtës të shenjave dalluese.
6. Vendet e cituara në pikën 5 të këtij neni duhet të jenë të shënuara me shenjën e përkatëse të arritshmërisë.

Në nenin 4, të Kreut II, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen kriteret e projektimit për arritshmërinë:

“1.14 Garazhet, vendi i të cilave duhet të lidhet me hapësirat e jashtme dhe me pajisjet e ngritjes, të përshatshme për përdorim nga personat në karrige me rrota.

Hapësira e rezervuar për ndalim qëndrimin e makinave në shërbim të personave me aftësi të kufizuara, duhet të ketë dimensione të tilla që të lejojë edhe lëvizjen e këtyre personave në kohën e hipjes në mjet. Ajo duhet bërë e dukshme nëpërmjet sinjaleve përkatëse horizontale dhe vertikale sipas standardeve të dhëna në pikën 2.14 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.

2.3 Parkimi konsiderohet i arritshëm nëse sipërfaqja në të cilën lëviz personi në karrigen me rrota është në të njëjtin plan me sipërfaqet e këmbësorëve të shërbimit ose lidhja midis tyre, në raste disnivelesh që kalojnë kufirin e lejuar, kryhet nëpërmjet platformave të pjerrëta ose të pajisjeve të përshtatshme të ngjitjes, sipas standardeve të dhëna në pikën 3.3 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.

Hapësira e rezervuar e ndalimit të makinave të personave me aftësi të kufizuara duhet të ketë të njëjtat karakteristika si në pikën 1.14 të këtij neni.

3. Sinjalistika në ndërtesa dhe nëpër hapësirat e arritshme duhet të vendoset në mënyrë të dukshme që të shihen lehtësisht tabelat me udhëzime për orientimin dhe shfrytëzimin e hapësirave të ndërtuara, duke dhënë informacionin e duhura mbi mënyrën e hyrjes nga personat me aftësi të kufizuara ose paaftësi lëvizëse. Në raste të tilla tabelat treguese duhet të kenë edhe simbolin tregues ndërkombëtar të arritshmërisë, shtojca A”.

Në Kreun IV, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen standardet dhe zgjidhjet teknike të detyrueshme për t’u zbatuar me qëllim për të garantuar mundësinë e përdorimit të hapësirave të jashtme nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Konkretisht në nenin 8, të VKM së sipërcituar, përcaktohen në mënyrë të detajuar standardet funksionale dhe të përmasave në hapësirat e jashtme, të detyrueshme për t’u respektuar. Kështu në pikën 3.3 përcaktohet:

“Kreu IV, Standardet dhe zgjidhjet teknike.

3. Hapësirat e jashtme.

3.3 Parkimet duhet të vendosen në masën minimale 1 në çdo 50 vende makinash, me gjerësi jo më të vogël se 320 cm dhe e rezervuar falas për makinat e personave me aftësi të kufizuara. Të ashtuquajtura vende makinash, të sinjalizuara, caktohen në ngjitje të vendkalimeve të këmbësorëve dhe në afërsi të hyrjes së ndërtesave ose pajisjeve. Me qëllim lehtësimin e transferimit të personit në karrige me rrota në kushte të njëjta atmosferike, preferohet që vendet e makinave të rezervuara të jenë të pajisura me mbulesë. Vendparkimi për PAK duhet të vendoset afër hyrjes së ndërtesës. Vendparkimi për automjete, kur parkimi bëhet pjerrtas apo për së gjati në raport me trotuarin për këmbësorët, madhësia e tij duhet të jetë 370 x 500 cm, figura 32 shtojca B. Nëse vendparkimi është për dy makina madhësia e tij duhet të jetë 590 x 500 cm me distancë ndërmjet tyre 150 cm, figura 33, shtojca B. Dalja nga vendparkimi dhe hyrja në trotuaret e këmbësorëve kryhet me një pjerrësi 10% dhe gjerësi 120 cm”.

Në nenin 26, të Kreut V, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohet se: “Në parkimet dhe garazhet publike, si dhe pranë objekteve ndërtimore 5% e vendeve përshtaten në raport me numrin total të vend parkimeve, por jo me pak se një”.

Në figurën 3, të shtojcës A, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, ilustruhet me figurë (1.25) shenja e parkingut të përshtatur për personat me AK, ndërsa në figurat 32 dhe 33 të shtojcës B, ilustruhet vendet e parkimit në varg dhe me hapësirë në mes, për personat me AK.

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr.1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, që duhet të përmbushin parkimet për personat me aftësi të kufizuara, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion nga ana e Tirana Parking, të dhënat në lidhje me vendet e parkimit në rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nën tokë) rezulton :

Sheshparkimet mbi dhe nëntokë, të cilat administrohen nga Tirana Parking, janë Sheshi “Italia”, Shehi “Skënderbej”, Sheshparkimi “Asllan Rusi” dhe “Selman Stërmasi”. Numri i vendeve të parkimit në këto sheshparike janë:

- Numri total i vendeve në sheshparkimin nëntokësor Sheshi “Skënderbej” është 303 vende dhe 15 prej tyre janë vendparkime për personat me aftësi të kufizuara. (duke përfshirë edhe vendet e parkimit të shtuara në dhjetor 2023)
- Numri total i vendeve në sheshparkimin nëntokësor Sheshi “Italia” është 198 dhe 2 prej tyre janë vendparkime për personat me aftësi të kufizuara.
- Numri total i vendeve në sheshparkimin “Asllan Rusi” është 76, ku 2 prej tyre janë vendparkime për personat me aftësi të kufizuara.
- Numri total i vendeve në sheshparkimin “Selman Stërmasi” është 84, ku 1 prej tyre është për personat me aftësi të kufizuara.
- Numri total i vendeve në sheshparkimin “Fryderyk Franciszek Chopin” është 80, ku 4 prej tyre është për personat me aftësi të kufizuara. (duke përfshirë edhe vendet e parkimit të shtuara në dhjetor 2023)

Të dhënat e mësipërme tregojnë se, jo të gjitha sheshparkimet për të cilat është dhënë informacion, plotësojnë kërkesën ligjore që të paktën 5% të vendeve të parkimit në raport me numrin total të vend parkimeve, të jenë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Pala ankuese pretendoi gjithashtu se, ashensorët e vendosur tek Sheshi “Skënderbej” dhe Sheshi “Italia” nuk punojnë, duke bërë të pamundur përdorimin e vendeve të rezervuara pa pagesë për personat me aftësi të kufizuara. Në lidhje me këtë çështje, Tirana Parking parashtroi se, ashensorët ishin çaktivuar nga ana e tyre për arsye sigurie. Në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.125, datë 22.12.2023 *“Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2024”* Tirana Parking deklaroi se, ka hartuar dhe miratuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2024, ku është përcaktuar marrja e shërbimit të ekspertizës për ashensorët. Aktualisht ekspertët e licensuar janë duke punuar për qartësimin e gjendjes teknike të ashensorëve dhe hartimin e preventivave të shërbimeve që do të kryhen për marrjen e certifikimeve të sigurisë për të gjithë ashensorët. Tirana Parking depozitoi në cilësinë e provës kopje të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2024, ku konstatohet se, në numrin rendor 11, është parashikuar objekti i prokurimit *“Shërbim ekspertize për ashensorët”*.

Lidhur me vendet e parkimit në rrugë, numri i vendeve të parkimit sipas Zonave A, B, C, që raportohet nga Tirana Parking paraqitet si më poshtë:

- Në zonën A të administrimit janë të përfshira 38 rrugë në të cilat përfshihen 1041 vende me pagesë, 582 vende pa pagesë dhe 48 vende për personat me aftësi të kufizuara.
- Në zonën B të administrimit janë të përfshira 25 rrugë në të cilat përfshihen 817 vende me pagesë 566 vende pa pagesë dhe 25 vende për personat me aftësi të kufizuara.
- Në zonën C të administrimit janë të përfshira 8 rrugë në të cilat përfshihen 342 vende me pagesë 315 vende pa pagesë dhe 13 vende për personat me aftësi të kufizuara.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se, nuk plotësohet kërkesa ligjore që të paktën 5% të vendeve të parkimit në raport me numrin total të vend parkimeve, të jenë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me përmbushjen e standardeve të parashikuara për vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara, pala ankuese pretendoi se ato nuk janë në përputhje me përcaktimet e VKM nr.1503/2008. Në lidhje me këtë pretendim, Tirana Parking parashtroi se, vijëzimi i vendeve të dedikuara për PAK kryhet në përputhje me parashikimet e nenit 147 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “*Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar dhe vendet e dedikuara janë të pajisura me sinjalistikën horizontale përkatësisht me shirita të verdhë (kufizimet) dhe të kundërsëhënuara me simbolin përkatës. Gjithashtu, vendet e dedikuara në sheshparkimet nëntokësore e mbitokësore përveç sinjalistikës horizontale janë të pajisura edhe me sinjalistikën vertikale përkatëse.

Në lidhje me respektimin e standardeve për vendet e parkimit të përshtatura për personat me aftësi të kufizuar, Komisioneri konstaton se, kuadri ligjor i zbatueshëm dhe kriteret teknike dhe standardet që duhet të përmbushin vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara, përcaktohen në VKM nr.1503/2008. Në rastin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara, Tirana Parking duhet të kishte respektuar kriteret dhe përcaktimet e parashikuara nga VKM nr.1503/2008 dhe jo kriteret dhe përcaktimet e përgjithshme që bëhen në lidhje me vendet e parkimit në VKM nr.153/2000.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara nuk janë në përputhje me standardet dhe kriteret teknike të përcaktuara nga legjislacioni i cili gjen zbatim në këtë rast dhe rrjedhimisht ato nuk janë të aksesueshme nga ana e personave me aftësi të kufizuar.

Sa i takon mbajtjes së lirë të vendeve të parkimit të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, Tirana Parking deklaroi se, nuk ka kompetencë për marrjen e masave administrative ndaj drejtuesve që kryejnë kundravajtje rrugore, ku përfshihen edhe parkimet në kundërshtim me sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Referuar pikës 1, të nenit 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “*Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar masat administrative kryesore “gjobë” dhe masat plotësuese “heqja e mjeteve”, të parashikuara në nenet 156, 157 të Kodit Rrugor, vendosen vetëm nga shërbimet e policisë rrugore, respektivisht nga Policia

Rrugore pjesë e Ministrisë së Brendshme dhe Policia Bashkiake. Në vijimësi ka kërkuar dhe vijon të kërkojë ndihmën e Policisë Bashkiake për marrjen e masave administrative për drejtuesit e mjeteve që parkojnë mjetet në vendet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët shfrytëzimin e hapësirave publike. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në hapësirat publike, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet aksesimi për të marrë shërbimet e ofruara.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Tirana Parking, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, i ka ekspozuar personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, në kuadër të administrimit dhe ofrimit të shërbimit të parkimit publik, në territorin në juridiksionin e Bashkisë Tiranë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Pala ankuese pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, në kuadër të administrimit dhe ofrimit të shërbimit të parkimit publik, në territorin në juridiksionin e Bashkisë Tiranë.

Në nenin 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Referuar nenit 1, të LMD, shkaku i diskriminimit *“aftësia e kufizuar”* i pretenduar nga pala ankuese, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara

nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁹. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹⁰. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹¹. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t’i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹².

KDPAK parashikon në nenin 9, të saj të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. KDPAK ndalon gjithashtu çdo formë diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, të ndryshuar, “diskriminimi” përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji,*

⁹ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹⁰ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹¹ Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹² Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet se ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”*

Në kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, të LMD parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD-së. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Të njëjtin rregullim, në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin 82, pika 2 të Kodit përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.

2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹³

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi, dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga pala ankuese duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

Për sa i përket pyetjes se çfarë e bën një provë *prima facie* të aftë për të zhvendosur barrën e provës tek subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Komisioneri do të mbështetet në parimet e përgjithshme që dalin nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Në çështjen *Baka kundër Hungarisë* (DHM) (nr. 20261/12, paragrafi 143, datë 23 qershor 2016), GJEDNJ shprehet se: “*Në veçanti, Gjykata miraton konkluzione që, sipas saj, mbështeten nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave, duke përfshirë konkluzionet e tilla që mund të rrjedhin nga faktet dhe parashtruesat e palëve. Prova mund të rrjedhë nga bashkëjetesa e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme ose të prezumimeve të ngjashme faktesh të pakundërshtueshme*¹⁴”.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me garantimin e parkimit të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur që në rastin konkret është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i

¹³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁴ Shih: GJEDNJ- *Baka kundër Hungarisë* (DHM), nr. 20261/12, paragrafi 143, 23 qershor 2016.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

janë nënshkruar personat me aftësi të kufizuara, për shkak të mosrespektimit të standardeve të aksesueshmërisë të miratuar nga aktet në fuqi, si më sipër janë cituar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pra të diskriminimit *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, kishte barrën e provës që të provonte se trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Aksesueshmëria është një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, përfshi edhe të drejtën për arsim. Megjithatë sipas KDPAK, sigurimi i aksesueshmërisë arrihet përmes realizimit progresiv.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se: *“E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambientet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë”*.

Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12).

Sipas pikës 10, të kreut I, të VKM-së, parashikohet gjithashtu se: *“Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë”*.

Vendimi nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në Kreun I, pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se: *“9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. 10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara”*.

Realizimi progresiv do të thotë se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Gjatë shqyrtimit të ankesës objekt shqyrtimi, Tirana Parking, pranoi se nuk është respektuar numri i kërkuar i vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara (5%). Tirana Parking deklaroi se përveç masave të marra për shtimin e numrit të vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara në muajin dhjetor 2023, do të vijojë gjatë vitit 2024 me plotësimi në masën 5% të vendeve të dedikuara në sheshet e tjera të parkimeve, respektivisht, sheshi i parkimit “Selman Stërmasi”, sheshi i parkimit “Asllan Rusi”, sheshi i parkimit “Italia”, sheshi i parkimit “Bulevardi i ri”, sheshi i parkimit “Rruga e Elbasanit”, sheshi i parkimit “Zoo Park” dhe sheshi i Parkimit “Diga”, me hyrjen në fuqi të kontartës së re të shërbimit të vijëzimit, në përputhje me grafikun e parashikuar për vijëzimin e shesheve të parkimit.

Mangësitë në realizimin e aksesueshmërisë në shërbime për personat me aftësi të kufizuara, janë evidentuar dhe në Planin Kombëtar për PAK 2021-2025, ku në pikën 3.1.1 “*Aksesueshmëria fizike*”, përshkruhet se: “*Rol dhe përgjegjësi të madhe në realizimin e aksesueshmërisë fizike kanë pushteti vendor. Nga ana e bashkive ka një mungesë të theksuar të zbatimit të VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.*

Për të siguruar aksesueshmërinë, KDPAK kërkon miratimin e disa standardeve minimale që duhet të përmbushen, standarde këto që rezultojnë të jenë miratuar, sikundër është parashtuar edhe më sipër në këtë vendim.

Referuar Komentit të Përgjithshëm nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “*Aksesueshmëria*”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: “*31. Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara të diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar: (a) kur shërbimi ose objekti është krijuar pas miratimit të standardeve përkatëse të aksesueshmërisë.....”*

Komisioneri vlerëson se, Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike¹⁵ që prej vitit 2008.

Masat e ndërmarra nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, për të rritur numrin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara janë të pamjaftueshme, pasi kërkesa në lidhje me numrin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuar, jo më pak se 5 % e numrit total të vendeve të parkimit, të jetë përshtatur për personat me aftësi të kufizuar,

¹⁵ VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.*

duhet të ishte respektuar që prej fillimit të ofrimit të shërbimit të parkimit publik nga ana e këtij institucioni. Për më tepër, në VKB nr. 49, datë 11.11.2015 “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe të tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”, në gërmën “a”, pika 3, të Aneksit 1, përcaktohet, shprehimisht detyrimi për të parashikuar vende parkimi për personat me aftësi të kufizuara në një masë jo më të vogël se 5 %.

Gjithashtu rezultoi se, vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara nuk respektojnë standardet teknike të përcaktuara në VKM nr.1503/2008, që është akti i cili gjen zbatim në rastin në shqyrtim, pasi Tirana Parking, deklaroi se në lidhje me vijëzimin dhe standardet teknike për vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara referohet tek VKM nr. 153, datë 07.04.2000, referim që sipas Komisionerit është i pabazuar.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshme është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: “duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar¹⁶ dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar¹⁷”.

¹⁶ Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

¹⁷ Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në lidhje me parkimet për personat me aftësi të kufizuara nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i bashkisë Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të lmd, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Tirana Parking, institucion varësie i bashkisë Tiranë nuk ka marrë masa për të siguruar standardet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, i standardeve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuar si dhe garantimi i masës 5 % të vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, në lidhje me garantimin e vendeve të parkimit të personave me aftësi të kufizuar në territorin e bashkisë.
2. Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, të marrë masa për të siguruar që, brenda 6 (gjashtë) muajve:
 - vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara të plotësojnë standardet teknike të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.
 - të garantohet detyrimi i përcaktuar në Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, sipas të cilit 5% e vendeve të parkimit duhet të përshtaten për personat me aftësi të kufizuara”.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Të mira dhe shërbime/Aksesueshmeri
Lloji i vendimit: Diskriminim i tërthortë